



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur, KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 91-të, të mbajtur më 31.08.2023, morri vendimin vijues:

## VENDIM

Lënda me numër 12-548/1 të datës 30.01.2023, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se pretendimet në denoncim nuk janë në korniza e saj për veprim kompetent.

Lënda me numër 12-548/1 të datës 30.01.2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

## Arsyetim

Lënda me numër 12-548/1 datë 30.01.2023 është formuar në bazë të denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i panjohur dhe ka të bëjë me dyshimet për diplomë të arsimit të lartë të marrë në mënyrë të paligjshme nga një person zyrtar ///, punonjës i ///, gjatë kryerjes së funksionit të drejtorit të kësaj ///. Parashtruesi ngre një dilemë në lidhje me pyetjen se si është e mundur që ky person zyrtar të jetë njëkohësisht drejtor dhe të studiojë në ///, d.m.th. nëse gjatë kryerjes së funksionit ka ndjekur ligjërata, ushtrime d.m.th. "///" kur fitoi "///". KSHPK-së i kërkohet shqyrtimi i çështjes në përputhje me kompetencat e saj ligjore.

Pas shqyrtimit të përmbajtjes së kërkesës, KSHPK-ja vlerësoi se pretendimet në denoncim nuk janë në juridiksionin e saj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar:  
- Ark8ivi i KSHPK-së.

Përgatiti: Mr. D.D  
Miratoi: K.N

**KOMISIONI SHTETËROR**

**PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**  
**Nënkryetar,**  
**Sofka Pejovska Dojçinovska**

